



Stadi: 01.09.2017

Aplikim për vizë me qëllim frekuentim shkolle

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhënë bashkëngjitur. Duke qenë i/e përgatitur mirë ju mund të ndikoni pozitivisht dhe të shkurtoni procedurën përkatëse.

Aplikimet e plotësuara në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit me pasojë rezervimin e një date të re aplikimi.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht 8 deri në 10 javë, në raste të veçanta edhe më gjatë. Ndaj lutemi për mirëkuptimin Tuaj për faktin që brenda 8 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës www.tirana.diplo.de

Gjatë procedurave të aplikimit Ambasada mund të kërkojë në raste të veçanta dokumenta të tjera shtesë, që nuk përmenden në këtë fletë informacioni. Lutemi vini re!: sipas legjislacionit të deritanishëm lëshimi i lejes së qëndrimit për frekuentim shkolle është i mundur **vetëm në raste përjashtimore** dhe duke nisur prej klasës së 9-të.

I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në original!

1.	Pashaporta e udhëtimit <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.	
2.	2x formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkuara personalisht.	
3.	3x fotografi	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë,	

			<p>madhësia 45x35 mm.</p> <p>->Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.</p>	
4.	Tarifa		Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhet kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.	
5.	Çertifikatë lindjeje e nxënësit <i>+ 2 kopje</i>		Originali i certifikatës së lindjes. Certifikatat që nuk janë në gjuhën gjermane dhe nuk lëshohen sipas një formulari ndërkombëtar duhet të përkthehen dhe të pajisen me vulën apostile. Përkthimi duhet të jetë i noterizuar. Duhet të dorëzohen nga dy kopje për certifikatën dhe përkthimin. Certifikatat shqiptare me formular ndërkombëtar NUK kanë nevojë të përkthehen, por duhet të pajisen me vulën apostile.	
6.	Kujdesi për personin	Një prind <i>+ 2 kopje</i>	<p>Vendimi i gjykatës shqiptare, në origjinal, për kalimin e të drejtës së kujdesit për fëmijën mbi njërin prind</p> <p>dhe</p> <p>deklaratë noteriale e dakordësisë së prindit tjetër të mbetur në Shqipëri me largimin e fëmijës në shoqërinë dhe kujdesin e prindit tjetër dhe me vendosjen e tyre në një banesë të përbashkët.</p> <p>ose</p> <p>Vendim i gjykatës shqiptare, në origjinal, për heqjen totale të të drejtës së kujdesit ndaj fëmijës kundër njërit prind.</p> <p>ose</p> <p>Certifikatë e vdekjes së njërit prind, në origjinal.</p> <p>Vendimet e gjykatës duhet të paraqiten me përkthimin përkatës dhe të jenë të pajisura me vulën apostile, për çdo rast nga dy kopje</p> <p>Lidhur me çertifikatën e vdekjes, krahaso nr. 5</p>	
7.		Dy prindër – me të drejtë të përbashkët kujdestarie <i>+ 2 kopje</i>	Deklaratë noteriale e dakordësisë së prindit tjetër të mbetur në Shqipëri me frekuentimin e shkollës nga fëmija në Gjermani (e përkthyer dhe me nënshkrime të noterizuara + 2 kopje)	
8.	Financimi <i>+ 2 kopje</i>		Dëshmi dhe sqarime rreth financimit (ndër të tjera pagesat e tarifave të shkollës etj.)	
9.	Dëshmi për shkëmbimin e nxënësve <i>+ 2 kopje</i>		<p>Në origjinal:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në rast shkëmbimi nxënësish me ndërmjetësimin e një organizate duhet të paraqitet konfirmimi i organizatës për shkëmbimin e nxënësve në Gjermani 	

		<p>O s e</p> <ul style="list-style-type: none"> Në rast të shkëmbimit të nxënësve pa ndërmejtësimin e një organizate për shkëmbime nxënësish kërkohet të paraqitet vërtetimi i shkollës dërguese në Shqipëri dhe asaj pritëse në Gjermani, që në këtë rast bëhet fjalë për një shkëmbim ndërkombëtar nxënësish, mbi bazën e një marrëveshjeje me një shkollë gjermane apo një institucion tjetër publik në bashkëpunim me një institucion publik në shtetin tjetër. <p>Ne origjinal, në dy kopje DHE ftesa e familjes pritëse apo të konviktit pritës, ku të garantohet fjetja dhe ushqimi.</p>	
10.	Dëshmi për qëndrimin në shkollën pritëse <i>+ 2 kopje</i>	<p>Në origjinal:</p> <p>Konfirmim i shkollës pritëse në Gjermani, sipas të cilit bëhet fjalë për një shkollë shtetërore apo të njohur nga shteti, apo për një shkollë e cila financohet pjesërisht apo tërësisht me fonde private, që përgatit nxënësit për përfitim e diplomave ndërkombëtare, apo diplomave të vendeve të tjera apo diplomave të njohura nga shteti dhe vecanërisht në rastin e shkollave me konvikt që kanë përbërje nxënësish me shtetësi të ndryshme ftesa e familjes pritëse apo e konviktit pritës, ku të konfirmohet se garantoet fjetja dhe ushqimi.</p>	
11.	Udhëzim mbi ligjin shqiptar	<p>Të miturit nevojiten të kenë me vete gjatë udhëtimit nga Shqipëria një deklaratë noteriale aprovimi të posaçme nga personat me të drejtë kujdestarie.</p>	

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.